**VENDIM**
**Nr. 1, datë 27.1.2016**

**MBI KUNDËRSHTIMIN E VENDIMIT TË ERE-s NR. 156, DATË 24.12.2015, "MBI LËNIEN NË FUQI TË VENDIMEVE NR. 139, NR. 140, NR. 141, NR. 145, NR. 146, NR. 147, NR. 148, DATË 26.12.2014, SI DHE TË VENDIMIT NR. 27, DATË 16.2.2015, TË BORDIT TË KOMISIONERËVE TË ERE-s PËR PERIUDHËN 1 JANAR 2016–30 QERSHOR 2016"**

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, dhe nenit 16, pika 3, të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 21, datë 18.3.2009, të ndryshuar, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.1.2016, pasi shqyrtoi kundërshtimin e shoqatës "AREA" dhe relacionin e përgatitur nga Drejtoria Juridike në lidhje me vendimin nr. 156, datë 24.12.2015, "Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe të vendimit nr. 27, datë 16.2.2015, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, për periudhën 1 janar 2016–30 qershor 2016",

konstatoi se:

1. Vendimi nr. 156, datë 24.12.2015, i Bordit të ERE-s, i bazuar në VKM-në nr. 125, datë 11.2.2015, "Për miratimin e metodologjisë të përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet", është botuar në Fletoren Zyrtare nr. 237/2015, si dhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

2. VKM-ja nr. 125, datë 11.2.2015, "Për miratimin e metodologjisë së përcaktimit të tarifave fikse të energjisë, për vitin 2015, që do t'u paguhen prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet", ka përcaktuar metodologjinë e përcaktimit të tarifave fikse të energjisë për vitin 2015 nga kjo kategori prodhuesish.

3. Vendimi nr. 1033, datë 16.12.2015, i Këshillit të Ministrave (botuar ne Fletoren Zyrtare nr. 221/2015), në nenin 2, sanksionon të drejtën e ERE-s për marrjen e masave në përcaktimin e një çmimi që do të aplikohet për një periudhë të ndërmjetme, në zbatim të vendimit nr. 125, datë 11.2.2015, të Këshillit të Ministrave.

4. Vendimi nr. 1033, datë 16.12.2015, i Këshillit të Ministrave ka parashikuar në nenin 3 të tij, se "Pas publikimit të raportit vjetor (*Physical futures Annual report*) nga bursa e Hungarisë HUPX, për vitin përkatës, siç është përcaktuar në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1033, datë 16.12.2015, ERE do të shprehet me vendim, "Mbi miratimin e tarifës fikse të energjisë për vitin 2016, prodhuesve të energjisë elektrike nga hidrocentralet".

5. Subjekti ankues mbështet kundërshtimin e tij në paligjshmërinë e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 125, datë 11.2.2015.

6. Ligji nr. 138/2013, "Për burimet e rinovueshme" në nenin 15, pika 3, përcakton se, ERE, në përputhje me metodologjinë e hartuar për tarifën fikse, çdo fundviti, miraton vlerat përkatëse të tarifave fikse, që duhet të paguhen për prodhuesit me përparësi.

7. Baza ligjore për paraqitjen e këtij ankimi mungon, dhe është e paqartë nëse subjekti që ka parashtruar kundërshtimin, kërkon me të rishikimin e vendimit apo shfuqizimin e tij.

8. Kërkesa për rishikim vendimi, referuar nenit 16, pika 5, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", dhe nenit 16 të "Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s", mund të kryhet nëse janë siguruar apo disponohen prova të reja, që mund ta çojnë bordin të marrë një vendim të ndryshëm.

9. Nuk konstatohet të jetë paraqitur asnjë provë e re që të çojë Bordin e ERE-s në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga vendimi objekt kundërshtimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Mospranimin e kërkesës së shoqatës "AREA" për kundërshtimin e vendimit të ERE-s nr. 156, datë 24.12.2015, "Mbi lënien në fuqi të vendimeve nr. 139, nr. 140, nr. 141, nr. 145, nr. 146, nr. 147, nr. 148, datë 26.12.2014, si dhe të vendimit nr. 27, datë 16.2.2015, të Bordit të Komisionerëve të ERE-s për periudhën 1 janar 2016–30 qershor 2016".

2. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë të interesuarit për vendimmarrjen e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet ne Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
**Petrit Ahmeti**